




Roli i Kontabilistëve dhe Auditorëve në Zhvillimin Ekonomik

E drejta e autorit © 2020 nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK). Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Kontabilistët dhe Auditorët profesionistë ofrojnë një kontribut të rëndësishëm në ekonomi në nivelin lokal, kombëtar dhe global. Në secilën masë të shqyrtuar, një numër më i madh i kontabilistëve dhe auditorëve ka lidhje me performancën e mirë ekonomike. Për më tepër, kontabilistët dhe auditorët profesionistë të cilët janë anëtarë të organizatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit anëtarë të FNK (OPK) ndërlidhen me performancën edhe më të fortë në indikatorët ekonomikë. Me pak fjalë, kontabilistët dhe auditorët ofrojnë një kontribut të rëndësishëm në ekonominë e tyre kombëtare. Kontabilistët dhe auditorët që janë anëtarë të një organizate profesionale të kontabilitetit e cila është anëtare në FNK ofrojnë një kontribut edhe më të madh domethënës.

NJË RRIJTE PREJ 500 KONTABILISTËVE/AUDITORËVE PËR MILION KORRESPONDON ME:	NËSE 500 KONTABILISTËT/AUDITORËT JANË ANËTARË TË OPK-VE ANËTARË TË FNK, RRIJTA KORRESPONDON ME:	NDRYSHIMI
 një rritje prej 5,073 USD në PBB për kokë banori	një rritje prej 11,224 USD në PBB për kokë banori	2.21x
 një rritje prej 3.3% në madhësinë e sektorit të shërbimeve në raport me PBB-në	një rritje prej 4.2%	1.27x
 një rritje prej 9.8% në vlerën e eksporteve krahasuar me PBB-në	asnjë marrëdhënie e rëndësishme statistikore	—
 një rënie prej 7.4% në shumën e normave tatimore	një rënie prej 9.8%	1.32x
 një rritje prej 16.0% në madhësinë e investimeve të huaja direkte përbrenda PBB-së	një rritje prej 34.3%	2.14x
 një rritje prej 0.3 pikësh indeksi në Matjen e Cilësisë së Edukimit Global të Indeksit Konkurrues të Forumit Ekonomik Botëror	indeksi një rritje prej 0.4 pikësh	1.33x

*Anëtarët e FNK përfshijnë më shumë se 175 PAO nga mbi 130 juridiksione në të gjithë botën. Jo çdo kontabilist dhe auditor është anëtar i një OPK të FNK, dhe jo çdo OPK është anëtar i FNK. Informacioni në lidhje me numrin e kontabilistëve dhe auditorëve të përgjithshëm merret zakonisht nga statistikat e botuara të tregut të punës, ndërsa informacioni mbi anëtarët e FNK vjen nga statistikat e anëtarësisë së FNK. Për më shumë informacion, kontaktoni member@ifac.org

Rreth gjetjeve

FNK bashkëpunoi me Qendrën për Ekonomi dhe Hulumtime të Biznesit (Cebr), një nga konsulentët kryesor të ekonomisë në botë, për të realizuar këtë hulumtim. Analiza shqyrtoi profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në vendet e G20 (përfshirë individualisht secilin vend të Bashkimit Evropian). Të dhënat u mbledhën nga një sërë burimesh, përfshirë Bankën Botërore, Forumin Ekonomik Botëror dhe Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, për qëllim të krijimit të marrëdhënieve në mes variablave ekonomikë dhe numrit të kontabilistëve dhe auditorëve si dhe anëtarëve të OPK.

